




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Skenderajt
Opštine Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për buxhet dhe financa

Raport mbi dëgjimet publike për buxhetin komunal të vitit 2021

Komuna e Skenderajt, edhe në vitin 2020 ka vazhduar me konsultime dhe dëgjime publike, kështu duke rritur nivelin e bashkpunimit me qytetarë.

Edhe përkundër faktit që jemi përballur me pandeminë COVID-19, komuna e Skenderajt nuk ka ndalur aktivitetet dhe projektet në interes të qytetarëve, duke mirëmenaxhuar situatën, poashtu në qytet dhe çdo bashkësi lokale, fshatra dhe lagje janë realizuar dhe po realizohen projekte kapitale, por realizimin e tyre, komuna dëshiron ta bëjë në konsultim me qytetarin, nevojat dhe kërkesat e qytetarëve, kështu do të vazhdojë me takime dhe konsultime të njëpasnjëshme.

Dëgjimi i parë buxhetor është mbajtur me datë 26.08.2020, në ora 14:00, në sallën e shtëpisë e kulturës 'Hasan Prishtina në Skenderaj, konform masave preventive ndaj pandemisë, ku pjesëmarrës ishin 102 persona.

Poashtu janë mbajtur edhe dy dëgjime publike online me datë 27.08.2020 dhe 28.08.2020, ku janë kyqyr 46 persona, nga qytetarë, ojq, përfaqësues të fshatrave dhe lagjeve të qytetit, me q' rast janë mbajtur procesverbali i takimit dhe listat e pjesëmarrësve, dhe pas paraqitjes së buxhetit, u pranuan edhe vërejtjet, sugjerimet, dhe kërkesat e qytetarëve, të cilat kryesisht ishin të lëmisë së infrastrukturës rrugore, kanalizime, ujësjellës, ndriqim publik, hapsira gjelbruese, trotuare, arsimit dhe shëndetësisë. Edhe nga kryetari i komunës dhe drejtori i finacave morën zotimin që kërkesat e tyre do të inkorporohen në buxhetin e vitit 2021, dhe do të punohet dhe veprohët me transparencë dhe sistem të hapur të qeverisjes dhe bashkpunimit.

Drejtori
Kastriot Gashi